



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 dhjetor 2011
Nr.Ref.:RK 154/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUSHMËRI

në

Rastin nr. KI48/10

Parashtruesi

Naser Rexhepi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut
VI.C.nr 54/2003, të 15 prillit 2003;**

dhe

**Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr 39/2003, të 19 qershorit
2003; dhe Rev.E nr 11/2003, të 18 majit 2004.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Naser Rexhepi, nga fshati Korreticë e ulët, KK Drenas, të cilin e përfaqëson avokati Imer Ibricaj, nga Komorani.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të kontestuara në Gjykatën Kushtetuese janë:

- a. Aktvendimi VI.C.nr 54/2003, i datës 15.04.2003 - Gjykata Ekonomike e Qarkut;
- b. Aktvendimi Ac.nr 39/2003, i datës 19.06.2003 - Gjykata Supreme e Kosovës; dhe
- c. Aktvendimi Rev.E nr 11/2003, i datës 18.05.2004 - Gjykata Supreme e Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më datën 30.06.2010, është vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatës Ekonomike të Qarkut: Aktvendimi VI.C.nr 54/2003, i datës 15.04.2003; Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës - Ac.nr 39/2003, i datës 19.06.2003 dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev.E nr 11/2003, i datës 18.05.2004.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullit 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 qershor 2010, Parashtruesi i kërkesës, paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 30 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës ia ka bashkëngjitur një “akt të përfaqësimit të përhershëm” (autorizim) të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Glogovcit për përfaqësuesin e tij ligjor në formën e dokumentit shtesë.
7. Më 26 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. ref.-DRLSA-1262/10 mb, kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës për kërkesën e parashtruesit, duke kërkuar njëkohësisht përgjigje në këtë kërkesë, por Gjykata Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar ligjor nuk mori asnjë përgjigje.
8. Më 16 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Ivan Cukaloviç, Kolegji shqyrtues i përbërë nga Robert Carolan (kryesues) dhe Prof. Dr. Enver Hasani dhe Dr. Iliriana Islami, anëtarë të kolegjit, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

9. Sipas pohimit të parashtruesit të kërkesës, z.Naser Rexhepi, që nga data 07.07. 1999 e deri më 01.06.2000, NTP “Fer-Treg”, me seli pune në Drenas (Glogovc), pronar i të cilës është ai, ka furnizuar me karburante Trupat Mbrojtëse të Kosovës (në tekstin e mëtejme: TMK) dhe këtë e mbështetë me kopjen e raportit të Zonës së parë të Mbrojtjes së TMK-së, në Skenderaj, nr. prot. 106/00 dt. 05.07.2000, të vulosur dhe nënshkruar nga Komandanti i zonës, Gjeneralmajor Sami Lushtaku, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së dhe ku specifikohet se kjo zonë është furnizuar me karburante në shumën e përgjithshme prej 80.763.44 DM, ose e konvertuar në Euro 41.293 €, shumë të cilën z. Naser Rexhepi pohon se nuk e ka marrë dhe se TMK ia ka borxh.

10. Me aktvendimin për lejimin e përmbarimit E, nr. 100/2002, të datës 7.10.2002, Gjykata Ekonomike e Qarkut ka lejuar përmbarimin në bazë të cilit TMK-ja, në cilësinë e të paditurës, duhet t'ia paguajë të paditurës NTP "Fer-Treg", me pronar z. Naser Rexhepi, shumë prej 41.293.89 € në emër të borxhit në afat prej 8 ditësh.
11. Më 15.04.2003, Gjykata Ekonomike e Qarkut duke vepruar sipas prapsimit të TMK-së ka nxjerrë Aktvendimin VLC. nr. 54/2003, me anë të të cilit shfuqizon vendimin e vet paraprak E, nr. 100/2002, të datës 7.10.2002, dhe propozimin për lejimin e përmbarimit e konsideron si padi, ndërsa në pikën 2 (dy) të këtij aktvendimi padinë e NTP "Fer-Tregu", me pronar z. Naser Rexhepi, e hedhë poshtë si të palejuar.
12. Më 19 qershor 2003, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.39/2003 ka REFUZUAR si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë VL.C nr.54/2003, të datës 15 prill 2003.
13. Paditësi NTP "Fer-tregu", me pronar z. Naser Rexhepi, ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme dhe kjo gjykatë me Aktvendimin Rev. nr.11/2003 ka refuzuar Revizionin e paditësit duke e vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme Ac, nr. 39/2003, të datës 19.06.2003.
14. I njëjti paditës ka bërë përsëri padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut për të njëjtën çështje, por kësaj radhe kundër: 1. TMK-së; 2. Gjenerallejtnant Agim Çekut dhe 3. Departamentit të Drejtësisë me seli në Prishtinë, dhe kjo padi me Aktvendimin III, C .nr.213/2005, të datës 27.10.2005, kundër të paditurit të parë, është hedhur poshtë si çështje e gjykuar ndërsa për dy të paditurit e tjerë është hedhur si e palejuar.
15. Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar në bazë të ankesës së paditësit me Aktvendimin Ac.nr.94/2005, të datës 14.12.2005, ka refuzuar ankesën e paditësit për pjesën e parë (I) të dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, gjegjësisht për çështjen e borxhit lidhur me TMK-në, ndërsa është ndryshuar pjesa lidhur me të paditurin e tretë (III) ku lënda i është dërguar Gjykatës Komunale në Prishtinë si gjykatë kompetente.
16. Përfundimisht, i pakënaqur me të gjitha aktgjykimet e lartcekura, z. Rexhepi më datën 26.06.2010 i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës nëpërmes përfaqësuesit të tij ka pretenduar se me vendimet e lartcekura gjyqësore atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, si: neni 10 - ekonomia e tregut, neni 22 pikat 1, 2, 7, 23, 24, 25, 26, neni 31 - e drejta në gjykim të drejtë, neni 36 e drejta e privatësisë, neni 49 e drejta e punës dhe e ushtrimit të veprimtarisë, etj.
18. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu ka pohuar se me aktvendimin për lejimin e përmbarimit E, nr. 100/2002, të datës 7.10.2002, Gjykata Ekonomike e Qarkut ka lejuar përmbarimin në bazë të të cilit TMK-ja, në cilësinë e të paditurës, duhet t'ia paguajë atij, si paditës, shumë prej 41.293.89 € në emër të borxhit në afat prej 8 ditësh. Më pas me aktvendimin e të njëjtës gjykatë të nxjerrë sipas prapsimit të TMK-së me nr. VI.C.nr 54/2003, të datës 15.04.2003, sipas parashtruesit të kërkesës në mënyrë jo ligjore është shfuqizuar aktvendimi i parë e i favorshëm për palën dhe ankesa e paditësit është hedhur si e palejuar. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr 39/2003, të datës 19.06.2003 dhe Aktvendimin Rev.E nr 11/2003, të datës 18.05.2004, ka refuzuar ankesën, përkatësisht revizionin kundër aktvendimit për shfuqizimin e aktvendimit E nr. 100/2002, të datës 7.10.2002, që ishte i favorshëm për parashtruesin e ankesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht i referohet nenit 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, ku thuhet:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë**, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"; dhe*

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

20. Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe përcaktohet:

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

21. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës, konstatohet se aktvendimi i fundit lidhur me kontestin e tij është nxjerrë nga Gjykata më 14.12.20005, ndërsa pala e ka pranuar atë më 15.02.2006.
22. Gjithmonë duke marrë parasysh afatet kohore, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të autoriteteve publike (Aktvendimi i fundit i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr.94/2005, i datës 14.12.2005), që daton nga një periudhë kohore para se Kushtetuta e Republikës së Kosovës të hynte në fuqi (15 qershor 2008) , prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve juridike me anë të të cilave supozohet shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, sepse në atë kohë ato as janë përcaktuar e as garantuar me Kushtetutë nga shkaku se vet Kushtetuta nuk ka ekzistuar, prandaj konstatohet se kërkesa është ratione temporis e papranueshme në raport me Kushtetutën. (shih shih Blečić v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, 29 korrik 2004, ku GJEDNJ kishte shpallë të papranueshme atë kërkesë sepse dispozitatat e Konventës Europiane për Drejtat e Njeriut nuk obligojnë palët kontraktuese lidhur me asnjë akt që është nxjerrë apo situatë juridike që ka përfunduar së ekzistuari para se konventa të hyjë në fuqi.)
23. Një arsyetim të tillë Gjykata Evropiane e kishte përdorë edhe kur e ka shpallur të papranueshme **Jasiiniene kunder Lituanië** (shih *mutatis mutandis Jasiiniene kunder Lituanië*, Kërkesa nr. 41510/98, Aktgjykimet e GjEDNJ-se te 6 marsit dhe 6 qershorit 2003).
24. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, prandaj:

PËR KËTO ARSYE


Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 16 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme sepse kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

